

## DPS merr pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e 10 vjetorit të themelimit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS)

Më 30 Prill 2015, AKS festoi 10 vjetorin krijimit të saj, ku e ftuar ishte edhe Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), e cila u përfaqësua nga Zoti Riza Hasanaj, Drejtori i Përgjithshëm dhe z. Gentian Gjyrezi, Drejtori i Standardeve.



Në këtë takim z.Hasanaj, theksoi marrëdhënien e shkëlqyer midis dy organizmave respektive të standardeve (AKS dhe DPS), ecurinë e deri tanishme të marrëveshjes midis AKS dhe DPS, diskutoi dhe gjeti dakordësinë edhe të përfaqësuesve të lartë të AKS, si z.Hafiz Gara Kryeshef i AKS, lidhur me:

1. Rishikimin në tërësi të Marrëveshjes ekzistuese midis DPS dhe AKS në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit midis dy Qeverive tona, asaj të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, në të gjitha fushat;
2. Informacion mbi përkthimin e standardeve të eurokodeve;
3. Azhornimin e listës së standardeve që disponon AKS;
4. Aksesimin e të dhënave të Standardeve Shqiptare nga databaza jonë (SMIS);
5. Mundësinë e heqjes së *watermark-ut* të DPS në Standardet Shqiptare për ato standarde që AKS blen nga DPS; si dhe
6. Uljen e çmimit të blerjes së standardeve nga AKS deri në 50%.

Gjithashtu, gjatë kësaj vizite në Prishtinë z.Hasanaj dhe z.Gjyrezi sëbashku me Kryeshefin e AKS dhe specialistë të saj, patën një takim pune me Zv.Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës, z.Avni Kastrati, në të cilin u theksua edhe një herë rëndësia e vazhdimësisë së bashkëpunimit në fushën e standardizimit dhe intensifikimit të saj, aty ku është e mundur, duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i DPS në organizmat europiane e ndërkombëtare të standardizimit si dhe të drejtën e *copyright-it* të standardeve të publikuara nga këto organizma.